



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PERGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.1736/12 prot.

Tiranë më 22.11.2023

VENDIM

Nr. 53, datë 22.11.2023

PËR KONTROLLUESIN “VIVERE TICKETING SHPK”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Vivere Ticketing SHPK” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 175, datë 26.10.2023, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Vivere Ticketing SHPK.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila si objekt veprimtarie ka tregtim dhe shitje biletash në vend ose në distancë (on-line sipas një platforme kompjuterike) për koncerte, festivale, evente, si dhe për çdo organizim me karakter kulturor, artistik, politik, etj. Shoqëria ndërton, administron, menaxhon dhe mirëmban platformën kompjuterike online për tregtimin dhe shitjen e biletave në distancë, etj.

Konstatohet se, gjatë aktivitetit të punës, Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna për kategoritë e subjekteve “Operatorë/Shitës”, “punëmarrës”, “klient”, etj.

2. Kontrolluesi ofron shitjen dhe menaxhimin online të biletave nëpërmjet sistemit “Biletaria” për subjektet e të dhënave. Për operatorët e palëve të treta operon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet agjentëve/brokerave. Gjenerimi i biletave bëhet online në formatin “pdf” dhe dërgohet automatikisht tek posta elektronike e përdoruesit.

Nga verifikimi në vend i sistemit “Biletaria” rezulton se, të dhënat personale për personat të cilët kanë gjeneruar një biletë për koncertin/aktivitetin, ruhen pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara, në atë formë që lejon identifikimin për një kohë të caktuar por, jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar, në përputhje me parashikimin e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Me përfundimin e qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

3. Konstatohet se, në faqen zyrtare [www.https://vivre.al](https://vivre.al), Kontrolluesi, krijon eventin që do të organizohet, nëpërmjet të cilës mund të pajisen me biletë klientët që duan të marrin pjesë.

Me qëllim gjenerimin e biletave online, Kontrolluesi mbledh të dhëna nëpërmjet rubrikës (*forma kontakti*), e cila funksionon si modul i sistemit online të biletave për klientët. Të dhënat që mblidhen në këtë rubrikë janë “emër”, “mbiemër”, “datëlindja”, “numër telefoni”, “gjinia”, “shteti”, “qyteti”.

Përpara gjenerimit të biletës, Kontrolluesi informon nëpërmjet rubrikave “*Termet & Kushitet*” dhe “*Jepni aprovimin tuaj*”, lidhur me përdorimin e të dhënave personale. Por, konstatohet se informimi nuk është i plotë në lidhje me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (*akses, korrigjim dhe fshirje*) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë

pasoja sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Vivere Ticketing, gjatë ushtrimit të veprimtarisë ka lidhur edhe disa kontrata të tilla si:
 - a. Kontratë nr. 742, datë 29.09.2023 midis palëve “Vivere Ticketing SHPK” dhe “Top Channel SHA”, me objekt “..Ofruesi i shërbimit merr përsipër të shes bileta për filmin e titulluar (**), organizuar nga klienti në datat 9, 10, 11 Nëntor 2023, në sallën kryesore të pallatit të Kongreseve”.
 - b. Kontratë shërbimi datë 01.10.2023 midis palëve “Vivere Ticketing SHPK” dhe “RedCloud SHPK” me objekt “...lehtësimin e procesit të blerjes së biletave për pjesëmarrjen në aktivitete artistike, sportive, kulturore etj., si dhe ofron mundësinë e shitjeve fizike të biletave në rrjetin e tij të partnerëve me anë të pikave fizike të administruara nga vetë ofruesi i shërbimit apo nga partnerë të tij ose nëpërmjet kanaleve/platformave online”.
 - c. Etj.

Në të gjithë kontratat e sipërcituara, subjekti “Vivere Ticketing SHPK”, cilësohet si “Ofruesi i shërbimit”, i cili merr përsipër të krijojë mundësinë për shitjen e biletave në rrjetet online përmes sistemit elektronik të tij, si dhe fizikisht nëpërmjet një rrjeti partnerësh. Në këtë kontekst, “Vivere Ticketing SHPK” gëzon cilësinë e përpunuesit, ndërsa subjekti tjetër që është lidhur kontrata/marrëveshje gëzon cilësinë e kontrolluesit, sipas përkufizimeve të nenit 3 të Ligjit.

Nga analiza e përmbajtjes së këtyre kontratave, rezulton se, nuk parashikohen detyrimet e palëve mbi përpunimin e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, palët duhet të miratojnë një kontratë tip, me anë të së cilës të garantojnë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien midis Kontrolluesit dhe Përpunuesit, kjo me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave tek përpunuesit, të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, palët duhet të specifikojnë masa konkrete teknike-organizative të detyrueshme për tu zbatuar nga ana e Përpunuesit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit rezultoi se, Kontrolluesi nuk ka përmbushur detyrimin për “Njoftim” në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Kontrolluesi pas marrjes në dijeni të Urdhrit të hetimit administrativ ka “Njoftuar” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës. Megjithatë, konstatohet se “Njoftimi” ka mangësi në deklaram, sa i përket rubrikave të formularit si vijon:

- i. Deklarimin në rubrikën 4, të formularit të njoftimit “*kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*”, të tilla si “*Numri i telefonit*”, “*Adresa*”, etj;
- ii. Deklarimin në rubrikën 6.1, të formularit të njoftimit “*qëllimi i përpunimit*”, të tilla si “*Statistikor*”;
- iii. Deklarimin në rubrikën 7.1, të formularit të njoftimit “*marrësi i të dhënave*” të tilla si “*institucione të ndryshme shtetërore*”;
- iv. Deklarimin në rubrikën 10.1, të formularit të njoftimit “*masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së të dhënave personale*”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për “Njoftim” mbi përpunimin e të dhënave personale, sikurse edhe përditësimi i vazhdueshëm i gjendjes së përpunimit, sipas parashikimeve të nenit 21 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre, sipas Ligjit.

6. Kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit për ofrimin e shitjeve të biletave përdor sistemin elektronik “*Biletaria*”. Ky sistem është i integruar në domain-in “*vivere.al*”, i cili është i hostuar në servera “*cloud*”, me vendodhje në Gjermani. Punonjës të Kontrolluesit kanë akses të plotë në sistemin “*Biletaria*”, si dhe në infrastrukturën ku ngrihet ky sistem.

Sistemi elektronik përbëhet nga module të ndryshme, të tilla si: “*Evente*”, “*Përdorues*”, “*Prioritete*”, “*Tours*”, “*Finance*”, “*Support*”, “*Email Logs*”, “*Filtra*”, etj., të cilat popullohen, ndër të tjera, me të dhëna personale.

Nga verifikimi në vend rezultoi se, sistemi popullohet me të dhëna nga vetë subjektet e të dhënave, si dhe nga llogaritë e përdoruesve të palëve të treta, në rolin e shitësit/operatorit. Konkretisht, moduli “*Evente*” popullohet online nga subjektet (*klientë që duan të marrin pjesë në event*) që kërkojnë të gjenerojnë bileta për aktivitetin, si dhe nga llogaritë e klientëve (*shitësi/operatori*) që organizojnë eventin, me të dhënat si vijon : “*emër*”, “*mbiemër*”, “*email*”, “*numri i telefonit*”, “*qyteti*”, “*shteti*”, “*username*”, “*datëlindja*”, “*gjinia*”.

Konstatohet se, për secilin aktivitet të zhvilluar nga Kontrolluesi, të dhënat personale që përpunohen gjatë gjenerimit të biletave, ruhen në një bazë të dhënash të përbashkët të strukturuar sipas modelit “*Tree data schemas*”, ku përfshihen të gjitha tabelat respektive. Ky sistem kryen ndërveprim me sistemin e pagesave të Western Union (në vijim, “WU”) sipas teknikës “*Application Programming Interface-API*”. Mënyra e pagesës për subjektet e të dhënave bëhet online nëpërmjet portalit pay.pokpay.io, si dhe fizikisht pranë WU duke gjeneruar një “*Order pagesë*” në faqen e internetit merchant.upay.al.

Nga kontrolli i aksesit në sistem rezulton se, janë 329 përdorues të krijuar nga administratorët në role të ndryshëm (*Shitës, Pr, Financë, Check-in, InfoPoint, As. Finance, vetëm-ftesa, statistika, support*).

Nga verifikimi on-site i sistemit elektronik “*Biletaria*”, si dhe nga shqyrtimi provave të administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se Kontrolluesi:

- Nuk ka të hartuar planin e politikave të vazhdueshmërisë së biznesit, dokumente këto që do të duhet të përmbanin politikat dhe objektivat që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemit;
- Nuk ka kryer një raport vlerësimi të sigurisë së sistemit;
- Nuk ka procedura/politika të dokumentuara për menaxhimin e riskut, teknikat e menaxhimit dhe të performancës;
- Nuk ka kryer Analizën e Ndikimit në të Dhënat Personale të operacioneve të përpunimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë;
- Nuk ka hartuar procedura të shkruara për mbajtjen e regjistrimeve lidhur me modifikimet, shkatërrimet dhe transferimet e të dhënave gjatë përpunimit të tyre;
- Nuk ka kryer auditime të brendshme me qëllim kontrollin e sigurisë së sistemit të përpunimit të të dhënave si dhe për garantimin e mirëfunksionimit të teknikave për menaxhimin e riskut.

Gjithashtu, rezulton se në datën 06.10.2023, nëpërmjet postës elektronike të domain-it “*proton.me*”, Kontrolluesi ka marrë njoftim se ka ndodhur depërtim në sistemin elektronik “*Biletaria*”, duke e provuar këtë me të dhënat e publikuara online në një Website të regjistruar, jo në Shqipëri.

Nga verifikimi në vend, konstatohet se të dhënat e publikuara të subjekteve të të dhënave në formatin (*csv dhe pdf*) janë të konsiderueshme dhe përkonin me të dhënat e mbledhura në sistemin e Kontrolluesit për gjenerimin e biletave të aktiviteteve (*maratona, në kuadër, finalmente, alpha show*), konkretisht: “*email, emër, mbiemër, vendi, data, bileta, gjinia, qyteti, shteti, monedha, produkte, username, ditëlindja, kodi i arkës, promocione, çmimi i plotë, etj.*”. Dokumentet e publikuara online, konsistojnë në:

- a) Folder “*në kuadër*”, përbëhet nga 809 bileta të gjeneruara në formatin “*pdf*”;
- b) Folder “*maratona*”, përbëhet nga 431 bileta të gjeneruara në formatin “*pdf*”;
- c) Folder “*finalmente*”, përbëhet nga 115 bileta të gjeneruara në formatin “*pdf*”;
- d) Folder “*some-database-data*”, përbëhet nga 85 files të gjeneruara në formatin “*csv*”, të mbi 49.141 rekorde rezervime, të subjekteve të të dhënave;
- e) Folder “*databases*”, përbëhet nga 605 files të gjeneruara në formatin “*csv*”, të mbi 17.670 rekorde rezervime, të subjekteve të të dhënave;
- f) Folder “*archives*”, përbëhet nga 1.570 bileta të gjeneruara në formatin “*pdf*”.

Kontrolluesi përdor shërbimet e sigurisë të “*Cloudflare Inc*” me qëllim përmirësimin e sigurisë, performancës dhe besueshmërinë e sistemit gjatë përdorimit të tij në internet. Nga verifikimet e kryera rezultoi se, shërbimi i sigurisë Cloudflare ka qenë i fikur nga data 14.09.2023, deri në momentin që Kontrolluesi është njoftuar për depërtimin e personave të paautorizuar në sistem duke shfrytëzuar vulnerabilitete/dobësinë e strukturës së sistemit. Rezulton se, periudha kohore në të cilën ka patur rrjedhje të dhënash (*data breach*), përkon me kohën e fikjes së shërbimit të sigurisë.

Referuar provave të administruara, si dhe verifikimit on-site të sistemit të “*Biletave*”, rezulton se, Kontrolluesi ka kryer veprime teknike sa i takon kufizimit të aksesit të personave të paautorizuar në sistem duke aktivizuar shërbimin e sigurisë Cloudflare, megjithatë konstatohen problematika si vijon:

- Nuk ka politika/procedura mbi gjurmimin (log-et) e sistemit dhe infrastrukturës TIK;
- Nuk ka procedura për përcaktimin e hapave që duhen ndërmarrë në rast incidentesh të shkeljes së sigurisë së të dhënave personale;
- Nuk ka kryer asnjë analizë teknike për depërtimin përdoruesve të paautorizuar që kanë shfrytëzuar vulnerabilitete të sistemit;
- Shkelja e sigurisë së të dhënave personale nuk është raportuar te Komisioneri.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, krijimi i procedurave dhe politikave të përdorimit të infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe sistemeve elektronike (konkretisht sistemit “*Biletaria*”) përbën një ndër masat kryesore që duhet të ndërmarrë Kontrolluesi, në lidhje me sigurinë dhe funksionimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Gjithashtu, Kontrolluesi duhet të kryejë auditime të vazhdueshme të sigurisë së informacionit gjatë përpunimit të tyre nëpërmjet sistemeve elektronike. Log-et, të cilat gjenerohen nga sistemi duhet të analizohen në mënyrë periodike me qëllim parandalimin e çdo cedimi të mundshëm të funksionimit të sistemit. Analizimi periodik i veprimeve/gjurmëve të përdoruesve apo të funksionimit të sistemit nëpërmjet log-eve, minimizon riskun dhe lokalizon problemin.

Krijimi i procedurave për vazhdimësinë e punës për Sistemet e Teknologjisë së Informacionit, duhet të jenë në përputhje me nenin 27 të Ligjit dhe Vendimin nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*”, si dhe praktikat më të mira të sigurisë së informacionit.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht në këtë rast kur përpunimi i të dhënave kryhet nëpërmjet komunikimeve elektronike, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 dhe 28 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*”, (në vijim, “*Udhëzimi nr.47*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi duhet të ndër marrë masa konkrete të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, sipas parashikimit të nenit 5, të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018 të Komisionerit “*Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre*”, (në vijim, “*Udhëzimi nr. 48*”), si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm nga organizata të akredituara dhe autorizuara sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48 të Komisionerit.

7. Kontrolluesi nuk disponon Rregullore “*Për mbrojtjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj., sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një Rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të

dhënave. Kjo Rregullore duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit u paraqit në seancë dëgjimore, ku parashtroj pretendimet si vijon:

➤ Sa i përket pikës katër të procesverbalit, përfaqësuesi i Kontrolluesit argumentoj se: *“Kontrata e analizuar është një kontratë standarde që Vivere Ticketing përdor me të gjithë klientët e saj, pavarësisht nëse ka ose jo shkëmbim të të dhënave personale, e cila përfshin parashikimin standard të nenit 6.5 në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Pavarësisht këtij parashikimi, Vivere Ticketing, shkëmben të dhëna vetëm me ata bashkëpunëtor ku shkëmbimi i të dhënave është i nevojshëm për të përmbushur detyrime teknike, dhe me këta bashkëpunëtor bashkëngjitur Aneksin F i cili është i modeluar sipas kontratës tip të parashikuar nga Udhëzimi nr. 19 i Komisionerit. Në rastet e marra në analizë nga grupi i inspektimit nuk kishte shkëmbim të dhënash dhe për pasoj nuk ishte e nevojshme bashkëngjitja e Aneksit F, i cili është Kontrata mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit, pasi ky rol nuk ekzistonte në kuptimin e Ligjit midis Vivere Ticketing dhe Top Channel Sh.A.*

Në lidhje me këtë pretendimin Zyra e Komisionerit vlerëson se nuk qëndron, pasi konstatimi nuk i referohet vetëm një Kontrate specifike, por plotësimin e detyrimeve të palëve mbi përpunimin e të dhënave personale sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit. Aneksi F, në të cilën pretendohet se aplikohen detyrimet e parashikuara nga Ligji, nuk është vendosur në dispozicion të grupit të kontrollit gjatë hetimit, apo gjatë seancës dëgjimore.

“Vivere Ticketing SHPK” me kërkesë të palëve të treta, sipas kontratës respektive, u mundëson krijimin e llogarive në sistem në rolin e shitësit. Shitësit të cilët janë nëpunës apo përfaqësues së përfituesve të shërbimit të ofruar nga *“Vivere Ticketing SHPK”* popullojnë sistemin me të dhënat personale duke gjeneruar bileta për secilin event. Pra, në të gjithë kontratat e sipërcituara, subjekti *“Vivere Ticketing SHPK”*, cilësohet si *“Ofruesi i shërbimit”*, dhe merr përsipër të krijojë mundësinë për shitjen e biletave në rrjetet online përmes sistemit elektronik të tij, si dhe fizikisht nëpërmjet një rrjeti partnerësh.

Siç edhe është konstatuar gjatë hetimit administrativ, “Vivere Ticketing SHPK” gëzon cilësinë e përpunuesit, ndërsa subjekti tjetër që është lidhur kontrata/marrëveshja gëzon cilësinë e kontrolluesit, sipas përkufizimeve të nenit 3 të Ligjit.

Ashtu sikurse është parashikuar edhe në pikën 1, të nenit 20 të ligjit, Kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave personale, mund të punësojnë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Çdo përpunues i të dhënave personale ka, ndër të tjera, detyrime:

- a) të përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit, të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi;
- b) të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas këtij ligji dhe të punësojë operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;
- c) të krijojë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale;
- d) Etj.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi dhe Përpunuesi nuk mund tu shmangen detyrimeve përkatëse, të cilat lindin gjatë dhe për shkak të zbatimit të kontratës, në lidhje me këtë ligj.

➤ Sa i përket pikës shtatë të procesverbalit, Kontrolluesi vendosi në dispozicion Rregullore “Për mbrojtjen e përpunimit, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj konstatohet se, Rregullorja është modeli “tip” që gjendet në faqen zyrtare të Komisionerit dhe nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., lidhur me veprimtarinë e Kontrolluesit, në kundërshtim kjo me parashikimet e nenit 27 dhe 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj. Kjo Rregullore duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale, në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Gjithashtu, sa i përket konstatimeve të tjera në procesverbal, Kontrolluesi është angazhuar për rekuperimin e tyre.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të germave “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”, si dhe të pikës 1 të nenit 39, të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, me informimin dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave personale.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 18, 20, 21, 22, 27, 28, 29, 30, 39 (pika 1, germat "a", "b", "ç", "d" dhe "dh"), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 120 000 (njëqind e njëzetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit;
4. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 dhe 22 të Ligjit;
5. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 300 000 (treqind mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit;

6. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje proceset e përpunimit të të dhënave personale, për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
7. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të ketë në vëmendje në vazhdimësi përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale;
8. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje në vazhdimësi përditësimin e “Njoftimit” në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës;
9. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit, duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
10. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të përfshijë në Rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj;
11. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, sa i përket krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;
12. Kontrolluesi, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar mbi certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48;
13. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) vazhdimisht, detyrimin e përcaktuar në pikat 6, 7 dhe 8 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 9 më sipër;
 - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 10 më sipër;
 - (iv) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 11 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

14. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

15. Gjoba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit;
16. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 22.11.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi